



Alumil

MANUALI I MIRËMBAJTJES

PËRMBAJTJE

Manuali i Mirëmbajtjes	2
1. Pastrimi	2
1.1. Letër mbrojtëse	3
1.2. Frekuenca e pastrimit	3
2. Mirëmbajtja	5
2.1. Kanalet e kullimit	6
2.2. Guarnicionet dhe vulat e shtyllave	6
2.3. Pajisje dhe aksesorë	7
2.4. Vida dhe sisteme fiksimi	7
2.5. Komponentët elektrikë	8
2.6. Doreza me tërheqje prej çeliku dhe inoksi	8
3. Modeli i regjistrave dhe regjistrimeve të mirëmbajtjes periodike	9

Manuali i Mirëmbajtjes

Funksionaliteti optimal i sistemeve ALUMIL varet nga mirëmbajtja korrekte dhe e rregullt e të gjitha pjesëve të tyre, duke ndjekur udhëzimet e përgjithshme. Duhet theksuar se produktet ALUMIL janë të cilësisë së lartë, me kusht që të mirëmbahen me kujdes. Një teknik i mirëmbajtjes me përvojë duhet të kryejë detyrat e nevojshme të mirëmbajtjes si dhe të plotësojë regjistrat e mirëmbajtjes periodike. Të gjitha materialet dhe pjesët rezervë që do të përdoren duhet t'i përmbahen standardeve të ALUMIL.

1. Pastrimi

- / Pjesët e veshura prej alumini duhet të pastrohen me solucion detergjenti pa tretës, jo qërryes dhe me pH neutral.
- / Pas pastrimit, shpëlajeni tërësisht pjesën e aluminit me ujë të pastër dhe thajeni duke përdorur një leckë thithëse ose mikrofibër, veçanërisht cepat dhe profilet e poshtme.
- / Mos përdorni zorrë uji ose larës me presion.



Para procesit të pastrimit duhet të ndiqen masat paraprake të mëposhtme:

- / Duhet të identifikohet saktësisht shtresa e përbërjes së sipërfaqes para procedurës së pastrimit.
- / Gjithmonë duhet t'i kushtohet kujdes të gjitha materialeve të tjera që mund të ndikohen nga lloji i pastrimit.
- / Pastruesit nuk duhet të përzihen.
- / Pastrimi duhet të kryhet gjatë kushteve të motit të butë, duke shmangur sipërfaqet që janë mbi nxehur ose jashtëzakonisht të ftohta
- / Mjetet me skaje të forta ose sipërfaqe të ashpra, të tilla si kruajtëse metalike, letër zmerile, etj., nuk duhet të përdoren pasi mund të dëmtojnë sipërfaqen. Pastrimi duhet të kryhet duke përdorur një leckë të butë.



1.1 Letër mbrojtëse

Një letër e tillë zakonisht aplikohet në sipërfaqen e veshur gjatë fabrikimit, për të shmangur dëmtimet mekanike dhe/ose të tjera (p.sh. çimento, gëlqere ose bojë). Shiritat e pastër duhet të hiqen pas një periudhe jo më të gjatë se tre muaj nga procesi i instalimit. Nëse kërkohet mbrojtje e mëtejshme, duhet të vendoset shiriti i ri. Shiriti duhet të aplikohet dhe hiqet siç rekomandohet nga furnizuesi i shiritit.

Çdo mbetje nga shiriti duhet të hiqet sa më shpejt që të jetë e mundur. Ndiqni udhëzimet e përmendura më sipër.

Në asnjë rrethanë mos përdorni tretës të fortë ose solucione që përmbajnë:

- / Hidrokarburet e kloruara
- / Esteret
- / Ketonet
- / Pastrues gjërryes ose lustrues

1.2 Frekuenca e pastrimit

Frekuenca e pastrimit varet nga disa faktorë, duke përfshirë:


- / Vendndodhja gjeografike e ndërtimit
- / Vendosja mjedisore e ndërtesës
- / Shkalla e ndotjes atmosferike
- / Era mbizotëruese
- / Mbrojtja e objektit nga strukturat fqinje
- / Mundësia e ndotjes ajrore (p.sh., rëra/pluhuri etj.) që shkaktojnë konsumim gjërryes të veshjes së profileve
- / Ndryshimet në kushtet mjedisore gjatë jetëgjatësisë së ndërtesës (p.sh., zonat rurale shëndrohen në zona industriale)
- / Përbërja e veshjes me pudër, për shembull:
 - ▶ Poliesteri standard - pastrimi më i rregullt
 - ▶ Poliesteri super i qëndrueshëm - pastrim më i rrallë



Detare - C4 Bregdetare



Industriale - C5 I



Pishinë

Frekuenca e pastrimit varet pjesërisht nga standardi i pamjes së jashtme dhe nevoja për të hequr papastërtitë, të cilat gjatë kontaktit për një kohë të gjatë me pudrën ose me nënshtresën metalike (nëse ekspozohen), mund të shkaktojnë dëme.

Si alumini i anodizuar ashtu edhe i lyster duhet të pastrohen rregullisht. Për zonat urbane jo bregdetare që nuk i nënshtrohen elementeve agresive si ndotja e ajrit ose ajri i kripur, mjafton të pastroni aluminin sa herë që pastroni xhamin.

Në zonat urbane ose në zonat buzë detit, si dhe në rajone që nuk janë të ekspozuara ndaj reshjeve, alumini duhet pastruar më shpesh sepse rreziku i degradimit të veshjes është më i lartë. Kjo është për shkak se kripa e fryrë nga era dhe ndotës të tjerë të ajrit mund të ngjiten në sipërfaqe dhe nuk do të pastrohen me reshjet.

Regjistrimet e orareve dhe frekuencave të pastrimit do të mbahen në regjistrat e mirëmbajtjes periodike.

Frekuenat e rekomanduara tregohen në tabelën e mëposhtme:

Klima		E butë			Jo e butë		
Mjedisi		Klasa 1	Klasa 2	Anodizimi	Klasa 1	Klasa 2	Anodizimi
Normale - C3 në brendësi		12 muaj	18 muaj	24 muaj	9 muaj	15 muaj	18 muaj
Detare - C4 Bregdetare	2000 to 5000 m nga vija bregdetare	12 muaj	18 muaj	24 muaj	9 muaj	15 muaj	18 muaj
	500 to 2000 m nga vija bregdetare	6 muaj	9 muaj	12 muaj	6 muaj	6 muaj	9 muaj
	50 to 500 m nga vija bregdetare	3 muaj	6 muaj	9 muaj	3 muaj	3 muaj	3 muaj
Industriale - C5 I	2000 to 5000 m nga burimi i ndotjes	12 muaj	18 muaj	24 muaj	9 muaj	15 muaj	18 muaj
	500 to 2000 m nga burimi i ndotjes	6 muaj	9 muaj	12 muaj	6 muaj	6 muaj	9 muaj
	50 to 500m nga burimi i ndotjes	3 muaj	6 muaj	9 muaj	3 muaj	3 muaj	6 muaj
Pishinë	Më e madhe se 2 m nga buza e pishinës	3 muaj	3 muaj	3 muaj	3 muaj	3 muaj	3 muaj

Tipi i Klimës		Shkalla e temperature	Temperatura më e lartë me RH ≥95%
E Butë		-33°C to 35°C	25°C
Jo e butë	Ngrohtë e thatë	-20°C to 40°C	27°C
	E thatë jashtëzakonisht e ngrohtë	3°C to 55°C	28°C
	Tropikal	5°C to 40°C	33°C

2. Mirëmbajtja

Inspektimi periodik i elementeve është shumë i rëndësishëm. Frekuenca e inspektimeve varet nga lloji, vendndodhja dhe numri i cikleve të funksionimit të çdo hapjeje dhe duhet të kryhet siç përshkruhet në tabelën më poshtë:

Përdorimi	Frekuenca
Përdorimi intensiv i sistemeve (shkolla, spitale, ndërtesa tregtare etj.)	Të paktën një herë në 3 muaj
Përdorimi normal ose i rrallë i sistemeve	Të paktën një herë në 6 muaj
Dyert e panikut (EN 1125)	Të paktën një herë në muaj
Sistemet që kanë të bëjnë me sigurinë	Më rregullisht, sipas legjislacionit të çdo vendi
Sisteme në kushte të rënda mjedisore (p.sh. zona industriale, det ose lumenj afër)	

Parregullsitë e vërejtura gjatë mirëmbajtjes duhet të raportohen menjëherë tek një teknik specialist i riparimit.



2.1 Kanalet e Kullimit

Në sistemet me hapje, pastroni pluhurin dhe papastërtitë e mbledhura midis guarnicioneve dhe kornizës me një fshesë me korrent.




Në sistemet rrëshqitëse ose dyert e palosshme, pastroni papastërtitë nga profili i poshtëm duke përdorur një fshesë me korrent.

Zhblokonti vëndin e kullimit duke përdorur një shkop të vogël pambuku.

Shinat duhet të pastrohen të paktën një herë në tre muaj, duke përdorur një leckë të butë për të hequr çdo send bllokues.


2.2 Guarnicionet dhe vulat e shtyllave



Të gjitha guarnicionet duhet të mirëmbahen siç duhet duke u pastruar me kujdes dhe duke aplikuar llak silikoni çdo vit. Vulat e shtyllave duhet të kontrollohen vizualisht për dëmtime.

2.3 Pajisje dhe aksesorë

Lubrifikoni dhe kontrolloni funksionimin e të gjitha pjesëve lëvizëse për funksion të lehtësuar të aksesorëve të kategorive të mëposhtme:



!! Aplikoni një sasi të arsyeshme të lubrifikantit dhe fshini çdo tepërcë nga sipërfaqja.

2.4 Vida dhe sisteme fiksimit

Të gjitha pjesët duhet të fiksohen saktë. Inspektoni fiksimin, dhe në rast të vidave ose pjesëve të lirshme, shtrëngimi ose zëvendësimi i tyre duhet të kryhet menjëherë nga stafi i autorizuar dhe i specializuar.

Të gjitha vidat duhet të shtrëngohen me forcë të moderuar. Në rast të forcës së tepërt, ekziston rreziku i zhveshjes së vidës ose thyerjes së pajisjes.



2.5 Komponentët elektrikë



- / Kontrolli i lidhjes së kablove duhet të ndjekë legjislacionin e instalimit të pajisjeve elektrike të çdo vendi.
- / Riparimet dhe mirëmbajtja e motorit dhe/ose bllokimit duhet të kryhen vetëm nga teknikë të kualifikuar.
- / Përpara mirëmbajtjes ose riparimeve, shkëputeni gjithmonë motorin nga furnizimi me energji elektrike.
- / Sigurohuni që uji të mos hyjë kurrë në kabinën e motorit, edhe gjatë pastrimit.

2.6 Doreza prej inoksi me tërheqje



Në kushte me lagështi, mund të shfaqen njolla kafe në sipërfaqe (kjo mund të përshpejtohet në zonat bregdetare). Këto pika nuk ndikojnë në forcën, integritetin ose jetëgjatësinë e materialit; është thjesht një çngjyrosje sipërfaqësore që kërkon pastrim për të rikthyer inoxin në pamjen e tij origjinale.

Nëse shfaqen njolla kafe në inox, ato mund të hiqen lehtësisht duke përdorur një pastrues të zakonshëm për sipërfaqet inoxi ose një sfungjer.



Për produktet e pastrimit dhe mirëmbajtjes, ju lutemi kontaktoni një përfaqësues të ALUMIL

Kodet e disponueshme	Përshkrim
EX-7707100000	ALU CLEANER 1LT ALUMIL
EX-7700000500	QUANTUM SILICONE SPRAY 400ML
EX-7672040000	MECHANISM LUBRICATOR 0,4 kg



Udhëzimet e mësipërme mbrojnë funksionimin e duhur të sistemeve ALUMIL. Duhet të theksohet se ALUMIL nuk mban asnjë përgjegjësi për dëmet e shkaktuara nga mirëmbajtja dhe përdorimi jo i duhur i konstruksioneve të aluminit. Për më tepër ALUMIL nuk do të jetë përgjegjës për çdo keqpërdorim të konstruksioneve të aluminit për një qëllim për të cilin ato nuk janë menduar.

ALUMIL ALBANIA SHPK

Autostrada Tirane-Durres,
Km7, Tirane
Tel: +355 48 240 230/1/2
Mob: +355 68 20 70 901
info.al@alumil.com
www.alumil.al

**ALUMIL HEAD OFFICES & SHOWROOM
THESSALONIKI**

Gogousi 8, Efkarpia
Thessaloniki - GR 564 29
Tel: +30 2313 011000
E-mail: info@alumil.com

ALUMIL HEADQUARTERS & FACTORY

KILKIS INDUSTRIAL AREA
Kilkis - GR 61100
Tel: +30 23410 79300
E-mail: info@alumil.com



www.alumil.com